



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS

## E drejta e Autorit: "Ministria e Kulturës afron librin për njerëzit që nuk shikojnë dhe me aftësi të kufizuara"

2017-09-13 15:51:00



Shqipëria merr pjesë në tryezën e përbashkët të vendeve anëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) për thellimin e bashkëpunimit për rafitikimin e traktatit të Marakeshit dhe Traktatit të Pekinit.

Shqipëria merr pjesë në tryezën e përbashkët të vendeve anëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) për thellimin e bashkëpunimit për rafitikimin e traktatit të Marakeshit dhe Traktatit të Pekinit.

Traktati i Marakeshit synon fundin e "urisë së librit dhe veprave artistike" për njerëzit që nuk shikojnë dhe me aftësi të kufizuara.

Ky takim u zhvillua në Moskë në datat 11 dhe 12 shtator, i organizuar nga Wipo dhe Rospatent.

Qëllimi i këtij takimi të nivelit të lartë është promovimi i këtyre traktateve me impakt të drejtëpërdrejtë tek me nevoja imediate për të aksesuar librin në format më të fundit të teknologjisë si dhe bërjes pjesë të një ndërkombëtar të bibliotekave nëpërmjet internetit.

Ministria e Kulturës paraqiti një përmbledhje të zbatimit të reformës së nisur vitet e fundit, miratimi dhe zbatimit të ligjit të ri për të drejtën e autorit, situatën rregullatore mes agjencive dhe biznesit për tarifën e shpërblyerjes hapat e mëtejshme për sportelin unik dhe ndërgjegjësimin e artistëve dhe përdoruesve mbi të drejtat pas morale mbi produktin intelektual.

Për këtë pala shqiptare angazhohet në hartimin e një draft plani nën asistencën teknike të WIPO-s për të marrë me pas me celjen e diskutimeve me grupet e interesit, Bibliotekës Kombëtare dhe atyre nëpër bashkitë e bashkuara dhe institucioneve përgjegjëse. E rëndësishme është që procesi i konsultimit publik të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të sensibilizojë këdo që mundet në jetësimin në praktikë të aksesit të këtyre kategorive në produktin intelektual artistik e shkencor.

Traktati i Pekinit mbetet një dokument kompleks dhe i rëndësishëm në perspektivën dhe qartësimin e marrëdhënieve mes producentëve dhe interpretuesve si dhe transferimin e të drejtave dhe skemat e shpërblyerjes traktat kërkon hapjen e një debati mes palëve dhe institucioneve duke u udhëhequr nga konteksti rajonal të BE-së për aderimin dhe zbatimin e tij në vendin tonë.